

# ***Raporti vjetor 2012***

---

***Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet***  
***Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet***



***Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet***

**Dhjetor 2012**

# **RAPORT**

## ***Mbi detyrat e realizuara për vitin 2012***

Mbrojtja nga rrezatimet e publikut, personelit dhe mjedisit për tani dhe për brezat e ardhshëm në Shqipëri është një proces në vazhdimësi, i cili kërkon një punë intensive të specialistëve të Zyrës për Mbrojtjen nga Rrezatimet dhe të gjithë atyre institucioneve, të cilët janë të lidhur si me sigurinë dhe sigurimin e burimeve të rrezatimit jonizues dhe jojonizues. Stafi i ZMR-së ka punuar si çdo vit në zbatim të funksioneve që jep ligji për mbrojtjen nga rrezatimet, ku misioni kryesor ka qënë të përgatisë dokumentat legale për mbrojtjen e punonjësve dhe publikut dhe mjedisit nga efektet e rrezatimeve duke zhvilluar dhe krijuar sistemin e administrimit dhe kontrollit të mbrojtjes nga rrezatimet, i cili siguron mbrojtjen në përputhje dhe me standartet ndërkombetare si të ANEA-s dhe EU-së. Megjithë problemet e hasura puna në ZMR gjatë vitit 2012 ka pasur një ngritje dhe problematika për mbrojtjen nga rrezatimet ka ardhur në rënie .

Në këtë kuadër ka gjetur mbështetje dhe udhëzimi bazë për detyrat kryesore dhe objektivat e vitit 2012.

Detyrat kryesore për vitin 2012 ishin:

1. Mbledhje dhe sistemim i dokumentacionit për subjektet private dhe shtetërore, të cilët aplikojnë për marrjen e licenses.
2. Realizim inspektimesh në rang prefekturë, të cilët nuk kanë plotësuar të plotë dokumentacionin për licensim.
3. Inspektim subjektësh, për ato subjekte që u ka kaluar afati i licenses dhe që përdorin burime të rrezatimit jonizues, si për sigurinë dhe sigurimin.
4. Pjesëmarrje në projektet me BE, ANEA, si dhe me Departamentin e Energjisë SHBA.
5. Përshtatja e legjislacionit tonë me atë të BE-së dhe plotësimi i matricës ligjore.
6. Bashkëpunim me departamentin e promovimit të ISHP për fillimin e një serie broshurash për promovimin e aktivitetit të zyrës dhe shpërndarjen e tyre në rang Republikë
7. Përditesimi i inventarit kombëtar i të gjithë burimeve të rrezatimit jonizues në RSH
8. Instalimi i RAIS në version SQL
9. Fillimi i procedurave për sistemimin e programit SAT mbi vetevlerësimin e trupës rregullatore.
10. Rishikim sipas raportit të vlerësimit nga ana e IAEA në lidhje me planin për përgatitjen dhe përballimin e emergjencave radiologjike .

11. Rritje e nivelit tone shkencor profesional nepermjet kualifikimeve te ndryshme, seminareve apo trajnimeve per te qene sa me eficente ne punen tone te perditshme dhe ne pjesemarrjen ne projektet qe kemi ne rang nderkombetar.

12.Miratimi nga KMR i dokumentit mbi “Strategjia dhe politikat kombetare per trajtimin e mbetjeve radioaktive ne Republiken e Shqiperise”.

13.Realizimi i marveshjeve te mirkuptimit me Republiken e Maqedonise,Malit te zi,Kosoves si dhe me Agjensine e Kontrollit Shteteror Shqiptar.

14.Percaktimi i kriterëve per fizikanet mjekesor, si dhe percaktimi i fazes tranzitore.

Matrica ligjore e parashikuar për vitin 2012

Projekt aktet	Objekti dhe qellimi i projektaktit	Ministri propozues	Afati i paraqitjes ne Qeveri
VKM Rregullore mbi sigurine e publikut ndaj ekspozimeve me burime te rrezatimeve jonizuese	Plotesimi i kuadrit ligjor në zbatim të ligjit Nr 8025 datë 09.11.1995 “Për rrezatimin jonizues”, i ndryshuar	Ministri i Shëndetësisë	4/3 (4- mujori i trete)
VKM Rregullore Rregullore mbi sigurine ndaj ekspozimeve mjeksore me burime te rrezatimeve jonizuese	Plotesimi I kuadrit ligjor ne zbatim te ligjit Nr. 8025, date 09.11.1995 “ Per rrezatimin jonizues “, i ndryshuar	Ministri i Shendetesise	4/3 (kater mujori i trete)
VKM Rregullore “Rregullore mbi sigurine e e publikut ndaj ekspozimeve te rrezatimeve	Plotesimi i kuadrit ligjor ne zbatim te ligjit Nr. 10469, date 13.10.2011 “ Per mbrojtjen nga	Ministri i Shendetesise	4/2 (kater mujori i dyte)

jojonizuese	rrezatimi jojonizues “,		
-------------	----------------------------	--	--

Në mbështetje të planit të punës për vitin 2012, ku janë të përcaktuara detyrat kryesore dhe objektivat bazë, Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka realizuar detyrat e përcaktuara. Këto detyra lidhen me :

pranimin e dokumentacionit të aplikuesve për marrjen e licensës;  
 vlerësimi i aplikimeve për licensë ;  
 inspektimi i kabineteve radiologjike si dhe subjektet që përdorin burime të hapura dhe të mbyllura në Republikën e Shqipërisë;  
 aprovimet e import/eksportit, transportit dhe transferimit të burimeve të rrezatimit jonizues; etj.

### **-LICENSIMI**

Në zbatim të ligjit Nr.8025 datë 09/11/1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, i ndryshuar si dhe rregullores mbi “Licensimin dhe inspektimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues” Nr.10 datë 07/01/2010, procesi i licensimit ka vazhduar normalisht dhe gjatë këtij viti ,që nga e faza e parë që është njoftimi e deri në fazën e fundit që është miratimi ose jo i licensës.

Janë miratuar nga KMR 17 licensa,nga të cilat 8 janë licensa te reja, 3 janë rinovim license, ndërsa 6 subjekte kanë amenduar licensën, 1 licensë është revokuar nga KMR për arsye se ndërtimi i këtij kabineti nuk ishte në përputhje me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë nr.415 datë 11.10.2011  
 Licensat e miratuara nga KMR për këtë vit janë si më poshtë:

- 1-SALUS,Tirana (CT-skaner,Grafi,CT-dentare,grafi dentare)
- 2-Klinika Medic-Alba,Vlorë (Grafi)
- 3-Grafi dentare Nr.1,Tiranë (Panoramex)
- 4-Coca-Cola Bottling,Tiranë (Am-241)
- 5-Klinika dentare Mehmeti, Berat( grafi dentare dhe panoramex)
- 6-Klinika Mjekësore “Komuna e Parisit” (grafi, panoramex,mamografi)
- 7-Amendim i licensës së QSUT,Departamenti i Radioterapisë( Sr-90)

8-Amendim i liçensës së Spitalit Hygeia mbi zhvendosjen e një aparature radiografi digitale

9-Amendim i liçensës Spitali Hygeia, Tiranë (burim kalibrimi Co-57)

10-Amendim i liçensës Mjekësia Bërthamore, QSUT, Tiranë (burim kalibrimi Cs-137)

11-Kompania "Stefani & Co", sh.a ( Am-241)

12-Weatherford Services L.T.D (gjenerator neutronik)

13-Amendim i liçensës për Spitalin Hygeia (PET-CT, F-18, Ge-68 për kalibrim si dhe terapi me I-131)

14-Kompania "Shchlumberger :

Gjenerator neutronik si dhe Burime radioaktive ( kategoria III, IV, V)

15- Amendim i liçensës së "Tirana International Airport", për ruajtje të përkohshme të burimeve radioaktive .

16-Spitali Rajonal "Ihsan Çabej", Lushnjë, (vetëm për pajisjen grafi/skopi)


17-Spitali Rajonal " Petro Nako" Sarandë, (vetëm për pajisjen skopi)

Në tabelën 1 është bërë një shpërndarje e burimeve të rrezatimit jonizues, sipas aparaturave me rreze X, burimeve radioaktive të mbyllura dhe të hapura, të cilat përdoren nga subjekte të ndryshme në fushën e mjekësisë, industrisë apo edukimit dhe shkencës, të cilat janë licensuar gjatë 2012


<b>Lloji</b>	CT	PET-CT	Grafi	Gr/dent dhe panor.	GR/Sk	CT-dentare	Burime rad të mbyllura	Burime rad te hapura	Gjenerator neutronik	Mam ografi	Ruajt je te perko hshme
<b>nr</b>	1	1	4	5	1	1	Kategori III,IV dhe V (5 qendra)	1	3	1	1

Tabela 1

Më poshtë kemi paraqitur dhe në mënyrë grafike nr e burimeve të rrezatimit jonizues të licensuar gjatë vitit 2012.



Grafik 3



Grafik 4

Në grafikun 3 është paraqitur ne përqindje nr i licensave të miratuara gjatë viteve, 2010, 2011 dhe 2012 .Vihet re se gjatë vitit 2012 numri i licensave të miratuara nga KMR është ulur dhe kjo për faktin se afati i licensës tashmë është pesë vjecar.

Risia e këtij viti ka qënë libereralizimi i aktiviteteve që lidhen me kryerjen e matjeve të rrezatimit jonizues dhe jojonizues, kalibrim të pajisjeve apo trajnime tek kompanitë private.

Në zbatim të udhëzuesit të miratuar nga KMR “Elementët për njohje nga ana e KMR-së për personat juridikë dhe fizikë që kryejnë matje me rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, kalibrim të pajisjeve radioametrike dhe matëse të rrezatimeve, trajnime dhe shërbim të dozimetrisë personale” Nr.1526/1 datë 13.04.2012, kompani të ndryshme kanë aplikuar pranë ZMR për njohjen e tyre nga KMR dhe kryerjen në mënyrë ligjore të këtyre aktiviteteve. Pranë ZMR kanë aplikuar :

1-Kompania Ekoteh Albania e cila do të kryeje matje të rrezatimit jonizues.

2-Instituti i Mbrojtjes nga Rrezatimet, i cili do të kryeje trajnime ne fushën e mbrojtjes nga rrezatimet

3-Instituti i Rrezatime, i cili do të kryeje trajnime ne fushën e mbrojtjes nga rrezatimet

4-Kompania “Edna-Farma”, e cila do të kryejë kontrollin teknik të pajisjeve me rreze-X.

KMR nuk ka miratuar njohjen e tyre për arsye se do të rishikohen kriteret, të cilat duhet të plotësohen nga këto kompani për të kryer aktivitetet e cituara më sipër.

## **-INSPEKTIMI**

Në bazë të planit të inspektimeve për vitin 2012 nuk është kryer pjesa më e madhe e inspektimeve të planifikuara, kjo për arsye të ngarkesës në punë si dhe mungesa e një makine për kryerjen e inspektimeve në rrethe. Gjatë 2013 kjo pikë do të jetë një nga prioritetet e ZMR si dhe angazhimi i stafit do të jetë më i madh në lidhje me këtë çështje, në mënyrë që të zbatohet plani i parashikuar i inspektimeve.

Gjatë 2012 janë realizuar inspektime në kabinetet e radiologjisë shtetërore dhe private që kanë në përdorim gjeneratorë me rreze X si dhe në ato qendra ku aplikohet me burime të hapura dhe të mbyllura radioaktive. Për kryerjen e inspektimeve janë vënë në dispozicion nga laborantja e ZMR-së, të gjitha pajisjet e nevojshme.


Inspektimet e realizuara gjatë 2012:

Subjekte Shtetërore:

1. Spitali Rajonal “Stefan Gjoni”, Krujë
2. Spitali Rajonal, Lac
3. Dispanceria, Lac
4. Qendra Shëndetësore Fushë Krujë
5. Spitali Rajonal Xhafer Kongoli, Elbasan
6. Spitali Rajonal, Librazhd
7. Spitali Universitar “ Shefqet Ndroqi”, Tiranë

Subjekte Private:

1. Klinika Jon, Elbasan,
2. Klinika Medicare, Elbasan
3. Hygeia Hospital, Tiranë




Grafik 1

Në grafikun 1 është paraqitur nr i inspektimeve të kryera në subjektet private dhe shtetërore gjatë vitit 2012.

Më poshtë paraqitet me grafik nr i inspektimeve të kryera gjatë 2012, karahasuar me vitet 2011 dhe 2010.





Grafik 2

### **-IMPORT-EKSPORTI I BURIMEVE TE RREZATIMIT JONIZUES**

Procesi i import –eksporteve të materialeve radioaktive ka funksionuar mbështetur në VKM për import-eksportet në Republikën e Shqipërisë, Nr.158 datë 13/02/2008, udhëzuesin mbi import-eksportin, tranzitin e burimeve radioaktive te kategorive 1 dhe 2 në Republikën e Shqipërisë Nr.134,date 12/04/2011 dhe rregulloren për “Import-eksportin dhe tranzitin e burimeve radioaktive”, Nr3918/4,date 3/11/2004.

Gjatë vitit 2012 janë dhënë 128 aprovime importi, një prej të cilave nuk është ekzekutuar për arsye teknike të subjektit .Gjatë këtij viti janë kryer kryesisht importe të burimeve radioaktive të mbyllura, të përfshira në grupin e sigurimit B, C dhe D, si dhe burime të hapura radioaktive të cilat kryesisht përdoren për ekzaminime “in Vitro” dhe “in Vivo”.

Për sa i takon eksporteve, gjatë 2012 janë eksportuar 3 burime Ir-192,të cilat janë përdorur për qëllime mjekësore . Eksporti është kryer sipas kontratave të nënshkruara për kthimin e burimeve radioaktive tek prodhuesi në fund të jetës së tij. Kthimi i burimit tek prodhuesi në fund të përdorimit ka qënë një nga strategjitë e punës tonë në mënyrë që të krijohen sa më pak mbetje në vend.

Më poshtë po paraqesim shpërndarjen e importeve dhe eksporteve të kryera gjatë vitit 2012 në mënyrë tabelore dhe grafike. Gjatë dy viteve të fundit vihet re një dyfishim i numrit të importeve, si rezultat i shtimit të numrit të subjekteve të licensuar, të cilët përdorin burime të rrezatimet jonizues në mjekësi, industri apo kërkime shkencore.

## Nr i aprovimeve mbi importin e burimeve të rrezatimit jonizues

Medicare	Univers Alb	Neo Style	Domi	Hygeia Hospital	QSUT	Schlumberger	Stefani &Co
25	26	15	1	28	28	1	1


Tabela 2

## Nr i aprovimeve për eksportin e burimeve të rrezatimit jonizues

<b>QSUT</b>
<b>3 burme (Ir-192)</b>


Tabela 3

Në grafikun 4 është paraqitur një shpërndarje e aprovimeve për import të burimeve të rrezatimit jonizues sipas kompanive të licensuara, të dhëna gjatë vitit 2012




Grafik 5

Në grafikun 5 është paraqitur nr i eksporteve te burime të rrezatimit jonizues gjatë 2012 sipas subjekteve.Gjatë këtij viti janë kryer vetëm 3 eksporte nga Qendra e Radioterapisë në QSUT.



Grafik 6



Grafik 7

Në grafikun 6 është krahasuar nr i import-eksporteve të miratuara gjatë vitit 2012 me import-eksportet e kryera gjatë 2010 dhe 2011. Nga grafiku vihet re se gjate dy viteve të fundit kemi një rritje të importeve.

### **-TRANSPORTI I BURIMEVE TË RREZATIMIT JONIZUES**

Transporti në Republikën e Shqipërisë kryhet nga subjekte të licensuar nga KMR dhe që zbatojnë të gjitha dispozitat e rregullores për “Transportin e sigurtë të materialeve radioaktive” Nr.488 datë 23.06.2010, si dhe të gjitha dispozitat e tjera që lidhen me transportin. Kompani të licensuara për kryerjen e transportin janë Qendra e Fizikës Bërthamore të Zbatuar, e cila është dhe e vetmja qendër e licensuar për kryerjen e transportit për të tretë, gjithashtu janë të lincsuara Qendra diagnostikuese Medicare dhe Hygeia Hospital, të cilët janë të detyruar të kryejnë transport vetëm për interesa të kompanisë së tyre dhe jo për të tretë.


Në lidhje me aprovimet e lëshuara nga ZMR për transportin, gjatë kësaj periudhe janë dhënë 130 aprovime transporti për burime të hapura dhe të mbyllura, nga të cilat 115 janë transport për burime të hapura, të cilat përdoren në mjekësi për diagnostikimin dhe terapinë e pacientëve, “in Vitro” dhe “In Vivo”, ndërsa 15 prej tyre janë aprovime transporti për burime të mbyllura radioaktive ,të cilat përfshihen në grupin e sigurimit B,C dhe D si dhe përdoren në fushën e mjekësisë dhe industrisë.

Një nga këto nga këto aprovime nuk është ekzekutuar për arsye teknike të subjektit.

Më poshtë po paraqesim një shpërndarje në mënyrë tabelore dhe grafike të aprovimeve të dhëna për këtë vit.


<b>Nr.i aprovimeve për transportin</b>	
<b>Medicare, QFBZ, HygeiaHospital Burime të hapura</b>	<b>Qendra e Fizikës Bërthamore e Zbatuar, burime të mbyllura</b>
<b>115</b>	<b>15</b>

Tabela 4



Grafik 8

Në grafën 8 është paraqitur në përqindje nr i aprovimeve për transport të dhëna për vitin 2012 të krahasuara me vitin 2010 dhe 2011



Grafik 9

## **-MBLEDHJET E KMR-së**

Gjatë këtij viti janë realizuar 5 mbledhje të KMR ku dhe janë marrë disa vendime.

KMR ka miratuar dokumentin mbi statusin e fizikanit mjekësor.

Për përgatitjen e këtij materiali janë marrë në konsideratë rekomandime të EU-së, IAEA-së dhe EFOMP-së si dhe janë studiuar eksperiencat e vendeve të ndryshme perëndimore lidhur me këtë ceshtje. Gjithashtu në materialin e përgatitur nga grupi i punës janë përcaktuar faza e parë si fazë tranzitore për fizikanët të cilët janë duke ushtruar këtë profesion në qendra të ndryshme spitalore, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilëve janë ekuivalente me ato që përcaktojnë standartet europiane. Faza e dytë është përcaktuar për fizikanët e ardhshëm mjekësor, të cilët duhet të ndjekin kurikulat që po përgatiten në nivel masteri dhe trajnimi klinik.

Faza e parë përfshin kushte të përgjithshme dhe kushte të vecanta, ndërsa për fazën e dytë, pjesë e rëndësishme e këtij procesi do të ishte vendosja e kriterit të trajnimit në klinikë pas masterit për një periudhë dy vjecare.

KMR gjatë këtij ka punuar dhe për dokumentin mbi “Strategjia dhe Politika kombëtare për menaxhimin e mbetjeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”.

Grupi i punës i ngritur për këtë ceshtje vendosi se, politika të trajtohet vec nga strategjia kombëtare, pra të jenë dy materiale të ndryshëm. Është përgatitur një draft, i cili pasi ti jepet forma përfundimtare do të miratohet nga KMR.

Dokumenti mbi Politikën për mbetjet radioaktive do të përfshijë të gjitha detyrimet që lidhen me këtë ceshtje. Gjithashtu, është rishikuar klasifikimi i mbetjeve duke e përshtatur me klasifikimin e mbetjeve të përcaktuara në dokumentat e ANEA-s, ku është marrë në konsideratë aktiviteti dhe periudha e gjysëm zbërthimit. Mendimi i grupit të punës është që materiali mbi politikën e mbetjeve radioaktive të përafrohet dhe me direktivën e EU-së.

KMR ka miratuar udhëzuesin mbi “ Proçedurat për lëvizjen fizike të materialeve radioaktive, mallrave dhe reagimit në rast incidenti me burime radioaktive në pikat doganore”. Materiali është përgatitur në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Në rastin e kontrollit të mallrave, të ndryshëm nga materialet radioaktive në pikat doganore, të cilat janë objekt i rregullores Nr.591, datë 18.08.2011, “Për nivelet e lejuara të përqëndrimit të radonit në ndërtesa dhe ujë, nivelet udhëzuese të radiobërthamave në materialet e ndërtimit, si dhe nivelet e lejuara të radioabërthamave në ushqime dhe produkte kozmetike”, vlerësimi i këtyre niveleve do të bëhet nga institucione të njohura nga KMR dhe se cdo parti malli do të verifikohet sipas metodikës dhe proçedurave të kontrollit. Më pas do të lëshohet një certifikatë konformiteti sipa modelit të dorëzuar në KMR. Në rast dyshimesh do të merren kampione për analiza të mëtejshme. Nëse do të

dedektohen burime radioaktive menjherë njoftohet KMR dhe QFBZ për asistencë.

KMR ka miratuar gjatë 2012 udhëzuesin “ Elementët për njohje nga ana e KMR-së për personat juridikë dhe fizikë që kryejnë matje me rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, kalibrim të pajisjeve radioametrike dhe matëse të rrezatimeve, trajnime dhe shërbim të dozimetrisë personale”. Në zbatim të këtij udhëzuesi, KMR ka marrë vendim se, të gjitha strukturat ekzistuese, që kanë kryer deri tani këtë lloj veprimtarie, të njoftohen në lidhje me këtë udhëzues si dhe të verifikohen nëse i plotësojnë këto kritere apo jo.

Nëse nuk i plotësojnë kriteret e miratuara nga KMR, t’u lihet një afat dy mujor për plotësimin e tyre dhe më pas do të pajisen me një certifikatë konformiteti(njohje).

Gjatë vitit 2012 është punuar dhe në lidhje me dokumentin mbi Amendimin e Konventës për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Radioaktive. Amendimet përbejnë një moment të rëndësishëm në përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për të përmirësuar më tej mbrojtjen fizike të materialeve bërthamore dhe të instalimeve bërthamore. Këto Amendime janë gjithashtu me rëndësi për sigurinë bërthamore dhe kanë një impakt të rëndësishëm për zvogëlimin e vulnerabilitetit të Shteteve Palë ndaj terrorizmit bërthamor.

Në lidhje me këtë çështje iniciativa është ndërrmarë nga Ministria e Mbrojtjes, e cila sipas procedurës ka bërë përkthimin e materialit, përkthim, i cili është certifikuar nga Ministria e Drejtesisë. Materiali iu është dërguar për mendim ministrive të linjës. MSH ka dërguar mendimin e saj në lidhje me materialin. Pasi të reflektohen në material të gjitha mendimet e ministrive të linjës do të dërgohet nga Ministria e Punëve të Jashtme për ratifikim në Parlament.

Në lidhje me programin RASIMS janë përcaktuar koordinatorët për TSA-të, Koordinator Kombëtar të jetë Z.Rustem Paci, ndërsa Fushat Tematike të Sigurisë do të mbulohen nga koordinatorët e mëposhtëm:

TSA 1 -Z.Rustem Paci

TSA 2 –Z.Kostandin Dollani

TSA 3- Znj.Drilona Kishta

TSA 4- Znj.Ida Muraj

TSA 5- Znj. Lediana Abazi

TSA 6- Z.Bardhyl Grillo

Në zbatim të Konventës së bashkuar për sigurinë e menaxhimit të lëndës djegëse të konsumuar dhe për sigurinë e menaxhimit të mbetjeve radioaktive”, të cilën Shqipëria e ka ratifikuar dhe është në fuqi që nga 27 Shtatori i vitit 2011, Shqipëria ka përgatitur gjatë 2012 raportin kombëtar, i cili paraqet të gjitha pikat që kanë të bëjnë me menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive. Referuar këtij raporti kombëtar, shtete të ndryshme kishin përgatitur rreth 31 pyetje për Shqipërinë. Për sa i

pëket përgjigjeve dhe përgatitjes së raportit është bashkëpunuar dhe me Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar.

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet ka përgatitur një dokument mbi “Standartet bazë të kontrollit teknik të pajisjeve me rreze X”. Materiali është përgatitur në përputhje me standartet europiane, megjithatë nuk është në formën përfundimtare dhe ka nevojë të rishikohet.

Është punuar, sipas kërkesës së Drejtorit të Komisionit Energjitik Atomik Grek për një aktmarreshje midis dy vendeve si dhe për një bashkëpunim si në fushën e rrezatimeve jonizuese dhe në atë jojonizuese.

Bashkëpunimi me institucionet përkatëse për sigurimin e burimeve radioaktive. Agjensia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike në Vjenë, nëpërmjet Zyrës së Sigurisë Bërthamore ka propozuar një program ku përfshihen aspekte ligjore dhe rregullatore, aspekte për parandalimin, dedektimin etj , nëpërmjet të cilit do të bashkëpunohet. me të gjitha institucionet përkatëse për sigurimin e burimeve radioaktive Gjithashtu ANEA në kuadër të këtij projekti ka propozuar që në një periudhë të përshtatshme, do të realizojë misionin e ekspertëve për vlerësimin e situatës në kufijtë e Shqipërisë në bashkëpunim me përfaqësues të KMR, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Policisë Kufitare, Shërbimit Informativ Shqiptar, Ministrisë së Jashtme si dhe përfaqësues të QFBZ. Grupi i punës do të diskutojë për fazën e parë, ngritjen e një infrastrukture, krijimi i së cilës, do të organizojë të gjitha institucionet e përfshira në këtë fushë.

Gjatë 2012 është punuar dhe mbi “Politika dhe strategjia në fushën e trajnimit”. Në lidhje me këtë është ngritur një grup pune i përbërë si më poshtë :

- 1-Rustem Paci Koordinator
- 2-Kostandin Dollani
- 3-Nikolla Civici
- 4-Bardhyl Grillo
- 5-Shkëlqim Mema
- 6-Sokol Frroku

Grupi i punës do të vazhdojë të punojë për përgatitjen e materialit dhe do t'a paraqesë në KMR brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2013.

Një çështje tjetër për të cilën është diskutuar gjatë në mbledhjet e KMR dhe me gjerë ka qënë “ Inspektimi për mbrojtjen nga rrezatimi si dhe reforma në inspektim”.

Në kuadër të ligjit Nr.10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është bërë grupimi i inspektoriateve dhe punonjësve që kryejnë funksione inspektimi, në njësitë lokale të



Inspektoriati Shtetëror. Inspektoriati i ri në fushën e Shëndetësisë, në zbatim të ligjit të sipërpërmendur do të përfshijë në këtë rast të gjitha fushat e inspektimit, përfshirë dhe inspektimin në fushën e mbrotjes nga rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese.

Mbështetur në praktikën e ndjekur në vende të ndrrshme të europës si dhe në dokumentin e ANEA-s, GSR- part III pika 1.11, standartet bazë të sigurisë kërkojnë vendosjen e një trupe rregullatore (në rastin tonë është vendosur KMR), e cila është përgjegjëse për zbatimin e funksioneve rregullatore si dhe vendosjen e një sistemi inspektimi për instalimet dhe aktivitetet me rrezatime dhe një sistemi legjislativ të sanksioneve, u mor vendim që inspektimi në fushën e mbrotjes nga rrezatimi të funksionojë kështu sic është duke bashkëpunuar me Inspektoriatin Shtetëror.

Një problematikë tjetër ka qënë në lidhje me aplikimet për njohje.

KMR ka marrë vendim që të bëhet rishikim i elementëve për njohje për personat fizikë dhe juridikë që do të kryejnë matje të rrezatimit jonizues dhe jojonizues, kalibrim të pajisjeve, trajnime dhe shërbim të dozimetrisë dhe të shtohet si kriter; lejet ose licensat që jepen nga institucionet përkatëse.

Gjatë këtij viti janë miratuar nga Këshilli i Ministrave rregulloret si më poshtë:

1-Vendim Nr.481, datë 25..07.2012 i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores “Sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve të rrezatimit jonizues”

2-Vendim Nr.743, date 16.10.2012 i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores “Sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve të rrezatimit jojonizues”

3-Vendim Nr.313, datë 09.05.2012 i Këshillit të Ministrave për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen e publikut nga shkarkimet në mjedis, përcaktimin e mostrave, rajoneve dhe frekuencës së matjeve”, pjesërisht në përputhje me Traktatin European Rekomandimin e 8 Qershorit 2000 “Mbi zbatimin e Nenit 36 të Traktatit European lidhur me monitorimin e niveleve të radioaktivitetit në mjedis me qëllim vlerësimin e ekspozimit të popullatës si një e tërë”.

Janë miratuar nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet dokumentat e mëposhtme:

1-Udhëzim mbi procedurat e vlerësimit të aplikimit për njohje nga KMR si fizikan mjekësor, nr. 4629/1, dt. 1.11.2012.

2-Udhëzim i KMR mbi “Procedurat e lëvizjes fizike të materialeve radioaktive, mallrave dhe reagimit në rast incidenti me burimet radioaktive në pikat doganore të hyrjes”, nr. 1526/2, date 13.04.2012 .

3-Udhëzim i KMR mbi “Elementët për njohje nga ana e KMR për personat juridikë e fizikë që kryejnë matje me rrezatimet jonizuese dhe jojonizuese, kalibrim të pajisjeve radiometrike dhe matëse të rrezatimeve, trajnime dhe shërbimin e dozimetrisë personale”, nr. 1526/1, date 13.04.2012.

4-KMR ka miratuar dokumentin “Statusi i fizikanit mjekësor në Shqipëri”, nr. 459, date 31.1.2012

Rregullore mbi : “Sigurinë ndaj ekspozimeve mjekësore nga burime të rrezatimit jonizues”. Është përgatitur drafti final dhe është dërguar për mendim ministrive të linjës.

ZMR ka përgatitur dhe matricën ligjore për vitin 2013, gjatë të cilit do të realizohen:

1-Hartimi dhe miratimi i Dokumentit Politika Kombetare per trajtimin e mbetjeve radioaktive ne republiken e Shqiperise  
Katermujori i dyte

2-Projektvendim per “Rregullore per percaktimin e e Standarteve baze per kontrollin teknik te pajisjeve mjekesore  
Katermujori i dyte

3-Rishikim i planit të përgatitjes dhe reagimit ndaj emergjencave radiologjike duke përfshirë dhe informimin e publikut. Kjo duke marrë në konsideratë dhe rekomandimet e ANEA nga Misioni i verifikimit në Nentor 2011

## **Problematika**

Një ndër problematikat e këtij viti ka qënë plotësimi i dokumentacionit nga spitalet rajonale shtetërore në rrethe, ku shumë prej tyre e kanë nisur këtë proces, por nuk është përfunduar, si rezultat i neglizhencës apo vështirësive për plotësimin e tyre dhe pse kanë pasur mbështetje nga ana jonë në çdo moment. Ministria e Shëndetësisë ka nxjerrë disa urdhëra, në mënyrë që të nxisin këto subjekte për vazhdimin e procesit për licensim,por që deri tani nuk kanë pasur rezultat.Në mbledhjen e KMR, datë 11.10.2012 është marrë vendim që do të përgatitet një urdhër i ri nga Ministri, Vangjel Tavo dhe do t’u dërgohet për zbatim të gjitha subjekteve shtetërore që përdorin burime të rrezatimit jonizues.

Një problematikë tjetër gjatë 2012 ka qënë dhe realizimi i shërbimeve në rrethe. Kjo për arsye të ngarkesës së punës si dhe mungesa e një makine për kryerjen e inspektimeve në rrethe.

Një shqetësim tjetër gjatë 2012 ka qënë mbulimi me dozimetri personale të punonjësve që punojnë me burime të rrezatimit jonizues. Duke marrë

shkak nga ankesat e subjekteve të ndryshme, ky shqetësim është ngritur dhe në mbledhjet e KMR-së, pasi krijohet një boshllëk në momentin e dorëzimit nga ana e subjekteve të dozimetrave personale. Sipas subjekteve, në momentin që bëhet dorëzimi i tyre nuk zëvendësohen me të rinj nga QFBZ. Procedura zgjat tre ditë deri në një javë, gjë e cila ndikon në monitorimin e ekspozimit të punonjësve. Për këtë është kërkuar që të merren masa, duke u bërë zëvendësimi i menjëhershëm i tyre si dhe të saktësohen mirë në kontratë sesi do të veprohet në bazë të pikave kontraktuale.

Gjithashtu gjatë 2012 për të shmangur problemet midis departamenteve të ISHP për shfrytëzimin e sallës së trajnimeve, ZMR përgatiti një rregullore për administrimin dhe menaxhimin e saj, e cila u miratua nga Drejtori i ISHP. ZMR është përgjegjëse për menaxhimin e saj.

## **PKMZSA**

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet po punon dhe për përshtatjen e legjislacionit shqiptar, që përfshin mbrojtjen nga rrezatimi me legjislacionin europian në kuadër të integritit të Shqipërisë në Europë. Detyrimet që duhet të përmbushë Shqipëria reflektohen në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKMZSA), që është instrumenti bazë i procesit të Integritit Europian. Ky dokument strategjik përfshin inisiativat ligjore dhe aktivitetet zbatuese të prioriteteve të adresuara nga Dokumenti i Partneritetit Europian (2007) dhe Raporti Vjetor i KE (2009), si dhe ka filluar puna për PKZMSA-në e re do të jetë një pikë e rëndësishme referimi për negociatat e ardhshme me BE-në duke u bazuar në edhe në Progres-raportet vjetore të Komisionit Europian, si edhe Progres-raporti 2012 i datës 10 tetor 2012, SËD (2012) 334.

Gjate këtij viti është siguruar pjesëmarrja në takimet e Nënkomitetit BE-Shqipëri për “Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Zhvillimin Rajonal”, si dhe janë përgatitur raportet përkatëse.

Është punuar sipas metodologjisë së përditësimit të PKZMSA dhe me sistemin online. Gjatë 2012 ZMR ka punuar dhe raportuar për progres raportin në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese dhe jo jonizuese.

## **BDTI**

Shqipëria është bërë përfshirë në sistemin e Bankës së të Dhënave për Trafikun Ilegal (BDTI) të lëndëve radioaktive pranë Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA). ZMR ka vazhduar punën me mbledhjen e të dhënave dhe sistemin e këtij lloji informacioni edhe me

formatin e ri që ka nxjerre Agjensia. Informacioni i marre arkivohet pranë ZMR i kategorizuar sipas burimeve radioaktive.

### **SEMINARE, TAKIME DHE TRAJNIME**

Është siguruar pjesëmarrja në seminare e takime të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar, sic mund të përmendim:

1-Takim i komitetit drejtues (RECAN) së vendeve të Evropës Lindore dhe vendet e Azisë Qëndrore, Vienë, Austri, 13-15 shkurt 2012

2-Kurs i avancuar për kërkimin dhe sigurimin e burimeve radioaktive, 2-6 Korrik 2012, Tiranë

3-Workshop Kombëtar me temë “Menaxhimi i mbetjeve radioaktive në Shqipëri” 10-12 Korrik 2012, në Tiranë

4-Workshop mbi aderimin dhe Implementimin e ndryshimeve 2005 të Conventës për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Berthamore, 25 - 27 Korrik 2012, Karlsruhe, Gjermani

5-Workshop për hartimin e rregulloreve mbi sigurinë bërthamore dhe rrezatimin jonizues, 11 Nëntor – 7 Dhjetor 2012, Vienë, Austri

6-Takim i komitetit drejtues (RECAN) së vendeve të Evropës Lindore dhe vendet e Azisë Qëndrore, 13-15 shkurt 2012, Vienë, Austri

7-Kursi Rajonal i Trajnimit për modelet e ekspozimeve në publik dhe mjedis lidhur me monitorimin e rrezatimit, 29 Tetor- 2 Nëntor 2012. Tiranë, Shqipëri

8-Kurs Rajonal i Trajnimit mbi sigurimin e transportit të materialeve radioaktive, 5- 9 Nëntor 2012, Karlsruhe, Gjermani.

9-Kurs Ndërkombëtar i Trajnimit mbi aspektet praktike të informacionit dhe menaxhimi i ruajtjes së të dhënave për kontrollin e burimeve radioaktive të mbyllura, 10- 14 Dhjetor 2012, Lubjanë, Slloveni.

10-Takim i nivelit teknik për rishikimin e udhëzuesit për mbrojtjen fizike të materialit bërthamor gjatë transportit, 23-27 korrik, 2012, Vienë, Austri

11-Takimi i III i Nënkomitetit BE-Shqipëri për “Transportin, Energjinë, Mjedisin dhe Politikën Rajonale”, datë 28-29 Mars 2012, Bruksel.

## **Administrimi**

1. Protokolli elektronik 2012
2. Dokumenta të hyra ne ZMR
3. Dokumenta të dala nga ZMR
4. Regjistrim i subjekteve që marrin leje importi /transporti
5. Lista totale e subjekteve që janë licensuar
6. Lista e subjekteve të licensuar ,të ndara sipas prefekturave
7. Lista e subjekteve që kane mbyllur aktivitetin
8. Lista e subjekteve që jane në proces

## **Temat e trajtuara ne dokumentet e hyra ne ZMR 2012**

1. Korespondenca me IAEA
2. Raport inspektimi “P ër mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”

### **Kerkesa ;**

1. për matjen e rrezatimeve
2. për aprovim projekti
3. për ushtrim aktiviteti
4. për bashkëpunim
5. për verifikim
6. për kryerjen e ekspertizave nga ZMR
7. marrje mendimi
8. për leje, automjet transporti te burimit radioaktiv

### **Aktmarreveshje ;**

1. për kontrollin dozimetrik personal
2. për kryerjen e transportit te burimit radioaktiv

### **Ftese pjesemarrje ;**

1. në workshop-e të ndryshme
2. në aktivitet trajnues,lidhur me gjetjen e burimeve

### **Ankesa ;**

1. Banorët e pallatit 21
2. Ekoteh Albania

## **Temat e trajtuara ne dokumentat e dala nga ZMR**

1. Raporte inspektimi
2. Plotësim i kriterëve për njohje nga KMR
3. Për plotësimin e procedurave te licensimit të veprimtarive me paisje të rrezatimit jonizues
4. Kthim përgjigje instuticioneve të ndryshme
5. Njoftime për worshop-in me temë “Menaxhimi i mbetjeve radioaktive ne shqiperi”
6. Vlerësim aplikimesh për njohje “Fizikan mjekësor”

